



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KONTIVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
 Dep. _____
 Dep. DPKI

Nr. i flet. _____
 Broj stranic _____
 Nr. pages _____

Nr. Prot. _____
 Broj prot. _____
 Prot. No. 06-01/2447/22

Data _____
 Dato _____
 Dm. 03.06.2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 02.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-06-2594/21, për zyrtarin e lartë z. Ekrem Mustafa, Deputet i Parlamentit të Republikës së Kosovës, për shkak të është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.**
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë, në rast se paraqiten rrethana të reja.**

A r s y e t i m

I. Pas identifikimit të rastit lidhur me papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik, Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtutjeshëm: Agjencia), ka hapur rastin me numër protokolli AKK-DPKI-06-2594/21, për zyrtarin e lartë z. Ekrem Mustafa, Deputet i Parlamentit të Republikës së Kosovës, duke zhvilluar procedurën e paraparë sipas Ligjit nr.06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia ka filluar trajtimin e rastit në fjalë, duke bërë fillimisht verifikimin dhe konfirmimin e këtij informacioni në institucionet përkatëse, prej nga rezultonte se z. Ekrem Mustafa, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, respektivisht Deputet i Parlamentit të Republikës së Kosovës, njëkohësisht ishte edhe Përfaqësues i Autorizuar në Biznesin “Epione” SH.P.K.

Më pas, në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia përmes shkresës zyrtare DPKI-06-01/1850/22, e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit.



Pas pranimit të kësaj shkrese, pala ka kontaktuar zyrtarin përgjegjës të Agjencisë i cili e ka njoftuar palën lidhur me rastin në fjalë, duke i sqaruar se gjatë ushtrimit të funksionit publik, në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, ai nuk mundet që njëkohësisht të jetë Përfaqësues i Autorizuar në biznes, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 13, paragrafi 1, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku thuhet se:

1. “Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, zyrtari i lartë z. Ekrem Mustafa është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se do të ndërmarr veprime të menjëhershme dhe konkrete në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare, me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Ekrem Mustafa ka bërë ndryshimet e kërkuara nga Agjencia dhe se i njëjti nuk figuron më të jetë Përfaqësues i Autorizuar në biznesin privat “Epione” SH.P.K.


Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë.

Prandaj, në bazë të asaj që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë, nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik,
- Drejtorit të DPKI-së,
- Zyrtarit përgjegjës.


Yll Buleshkaj
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit